FLETËUDHËZUES I PAKETIMIT:
Informacion për pacientin

SULFAT MAGNEZI

Tretësirë për injeksion – 2500 mg / 10 ml (25%)
(Sulfat magnezi)

Lexojeni me kujdes këtë fletëudhëzues përpara se të filloni përdorimin e barit.

- Ruajeni këtë fletëudhëzues. Mund të keni nevojë ta lexoni përsëri.
- Në qoftë se keni pyetje të mëtejshme, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.
- Ky bar është përshkruar për ju. Mos e jepni tek persona të tjerë. Mund t'i dëmtojë ata edhe pse mund të kenë të njëjtat simptoma si ju.
- Në qoftë se ndonjë prej efekteve anësore keqësohet ose në qoftë se vëreni ndonjë efekt tjetër anësor që nuk përmendet në këtë fletëudhëzues, ju lutemi të njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj.

Në këtë fletëudhëzues:

1. Çfarë është Sulfat magnezi dhe përse përdoret
2. Përpara se të merrni Sulfat magnezi
3. Si ta merrni Sulfat magnezi
4. Efekte anësore të mundshme
5. Si ta ruani Sulfat magnezi
6. Informacion i mëtejshëm

1. ÇFARË ËSHTË SULFAT MAGNEZI DHE PËRSE PËRDORET

Magnezi parandalon ose kontrollon konvulsionet duke bllokuar përçimin neuromuskulor dhe duke zvogëluar sasinë e acetilkolinës të çliruar nga lamina terminale me anën e impulsit të nervit motor. Magnezi ka një efekt deprimues në sistemin nervor qendror. Nivelet plazmatike normale të magnezit luhaten nga 1.5 deri në 3 milibarazvlerës / l. 1 g sulfat magnezi jep 8.12 milibarazvlerës magnez.

Sulfat magnezi, tretësirë për injeksion, 2500 mg / 10 ml përdoret në:

- parandalimin ose kontrollin e konvulsioneve në preeklampsi ose eklampsi të rëndë, pa shkaktuar deprimim të dëmshëm të sistemit nervor qendror te nëna ose foshnja dhe të konvulsioneve të shoqëruara me hipomagnezemi;
- kontrollin e hipertensionit, encefalopatisë dhe konvulsioneve në fëmijët me nefrit akut;
- frenimin e lindjes së parakohshme;
- trajtimin e aritmive ventrikulare kërcënuese për jetën.

2. PËRPARA SE TË MERRNI SULFAT MAGNEZI

Mos merrni Sulfat magnezi

- në qoftë se jeni të mbindjeshëm ndaj sulfatit të magnezit;
- në qoftë se jeni shtatzënë, gjatë 2 orëve para lindjes.

Tregoni kujdes të veçantë me Sulfat magnezi

Pyesni mjekun tuaj përpara se të merrni Sulfat magnezi në qoftë se keni insuficiencë renale sepse kjo insuficiencë mund të shpjerë në helmimin me magnez.
Tretësira për injeksion e sulfatit të magnezit injektohet në venë, në eklampsi, vetëm për kontrollin e menjëhershëm të konvulsioneve kërcënuese për jetën.
Injeksioni intramuskular është i dhimbshëm.
Pacienti duhet të monitorohet për shenja klinike të mbidozimit të magnezit (shih Efektet anësore).
Ka të dhëna se administrimi i vazhdueshëm i injeksionit të sulfatit të magnezit për më gjatë se 5 – 7 ditë në shtatzëni për trajtimin e lindjes së parakohshme, mund të shkaktojë nivele të ulëta të kalçiumit dhe ndryshime të kockave tek foshnja.

Marrja e barnave të tjera

Trajtimi i njëkohshëm me barna të tjera mund të ndikojë ose të ndikohet nga Sulfat magnezi.
Ju lutemi të kontaktoni me mjekun ose farmacistin tuaj në qoftë se jeni duke marrë ose keni marrë kohët e fundit barna të tjera, përfshirë ato të marra pa recetë. Mos harroni të informoni mjekun tuaj për trajtimin me Sulfat magnezi në qoftë se ju jepet ndonjë bar tjetër gjatë trajtimit.
Është **veçanërisht e rëndësishme** që mjeku juaj të jetë në dijeni të faktit që ju jeni trajtuar me:

- bllokues neuromuskulorë;
- nifedipinë; është raportuar hipotension i theksuar me përdorimin e njëkohshëm të magnezit parenteral dhe nifedipinës në pre – eklampsi.

Marrja e Sulfat magnezi me ushqim dhe pije

Nuk ka të dhëna të mjaftueshme.

Shtatzënia

Kërkoni këshillën e farmacistit ose të mjekut përpara se të merrni këtë bar.

Sulfati i magnezit nuk duhet përdorur në shtatzëni 2 orë para lindjes.
Ka të dhëna se administrimi i vazhdueshëm i injeksionit të sulfatit të magnezit për më gjatë se 5 – 7 ditë në shtatzëni për trajtimin e lindjes së parakohshme, mund të shkaktojë nivele të ulëta të kalçiumit dhe ndryshime të kockave tek foshnja.

Ushqimi me gji

Nuk është konfirmuar siguria gjatë ushqimit me gji. Prandaj, nëse nuk është i domosdoshëm, nuk këshillohet marrja e sulfatit të magnezit gjatë kësaj periudhe.

Drejtimi i automjetit dhe përdorimi i makinerive

Ky bar nuk ka ndikim mbi aftësinë për të drejtuar automjetin dhe përdorur makineri.

3. SI TA MERRNI SULFAT MAGNEZI

Gjithmonë merreni Sulfat magnezi sipas këshillës së mjekut. Në qoftë se nuk jeni i sigurt, kontaktoni me mjekun ose farmacistin. Në qoftë se ndjeni që efektet e Sulfat magnezi janë shumë të forta ose shumë të dobëta, flisni me mjekun ose farmacistin tuaj.
Administrimi në venë bëhet i holluar.
Me injektim në muskul: 8 deri 10 ml tretësirë 25%, në rast nevoje çdo 4 orë.
Me injektim në venë: 4 ml të tretësirës 25%, pa e kaluar shpejtësinë 0.75 ml / min.
Me perfuzionim në venë; 4 deri 5 ml në 250 ml tretësirë glukoze 5% ose tretësirë klorur natriumi 0.9%, pa e kaluar shpejtësinë 3 ml / min.
Fëmijët: Me injektim në muskul, 20 – 40 mg/kg të tretësirës 25% të holluar; në rast nevoje doza përsëritet.
Sulfat magnezi nuk është kimikisht i përputhshëm me hidroksidet alkaline (formohet hidroksid magnezi i patretshëm), karbonatet alkaline (formohet karbonat magnezi i patretshëm) dhe salicilatet.

Në qoftë se keni marrë më shumë Sulfat magnezi

Në qoftë se keni marrë më shumë Sulfat magnezi se sasia që duhet të merrnit, ose në qoftë se fëmijët e kanë marrë gabimisht këtë bar, ju lutemi të kontaktoni mjekun tuaj, spitalin, ose të telefononi urgjencën për të marrë një mendim për rrezikun dhe këshillë për veprimet që duhet të ndërmerren.
Në pacientët me dëmtime renale duhet të kihet kujdes se insuficienca renale mund të shpjerë në helmim me magnez.

Në qoftë se harroni të merrni Sulfat magnezi

Në qoftë se harroni një dozë (ose më shumë doza), merrni dozën në vazhdim kur të jetë koha për marrjen e zakonshme të saj.
Mos merrni një dozë të dyfishtë (ose më të lartë) për të plotësuar dozën (dozat) e harruar(a).
Në qoftë se keni pyetje të mëtejshme mbi përdorimin e këtij produkti, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.

4. EFEKTE ANËSORE TË MUNDSHME

Si të gjitha barnat e tjera, Sulfat magnezi mund të shkaktojë efekte anësore, megjithëse jo çdokush i manifeston.
Pjesa më e madhe e efekteve anësore janë të lidhura me dozën dhe zhduken kur doza reduktohet ose trajtimi ndërpritet.
Nga përdorimi i dozave të tepërta parenterale të kripërave të magnezit shkaktohet hipermagnezemia, e cila paraqet shenjat e mëposhtme: deprimim i punës së zemrës, kolaps cirkulator, ndërprerje e punës së zemrës, deprimim i sistemit nervor qendror, dobësi muskulore, hipokalçemi, skuqje e fytyrës, djersitje, hipotermi, të përziera, të vjella, konfuzion, etje, frenim respirator, humbje e reflekseve të tendinave, koma, hipotension.
Në qoftë se ndonjë prej efekteve anësore përkeqësohet ose në qoftë se vëreni efekte anësore që nuk përmenden në këtë fletëudhëzues, ju lutemi të lajmëroni mjekun ose farmacistin tuaj.

5. SI TA RUANI SULFAT MAGNEZI

Mbajeni larg fëmijëve.
Mos e përdorni Sulfat magnezi pas datës së skadimit e cila është e shënuar në paketim.
Të ruhet nën 25°C.
Ruajeni në paketimin origjinal për ta mbrojtur nga drita.

6. INFORMACION I MËTEJSHËM

Çfarë përmban Sulfat magnezi

Lënda vepruese është Sulfat magnezi heptahidrat.
Çdo ampulë 10 ml përmban 2500 mg sulfat magnezi heptahidrat.
Përbërës të tjerë: ujë për injeksion.

Përmbajtja e paketimit

Kuti me 10 ampula; Kuti me 100 ampula (përdorim spitalor).

Shpjegues i ikonave ilustruese në paketim:

Merret vetëm me recetën e mjekut.

Përmbajtja. ! Kujdes.

Tretësirë për injeksion .

Mbajtësi i autorizimit të tregtimit dhe prodhuesi:

PROFARMA Sh.a.
Rruga "Myslym Keta"
Tel.: 00355 4 23 89 602
Tiranë - SHQIPËRI

Ky fletëudhëzues u rishikua për herë të fundit në Korrik 2012.

SPECIFICATION

CROPING AREA 12 x 19 cm

PAY ATENTION, all the layers are visible.
If you have to print this document please check or uncheck the specific layers.